

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Që në fillim dua të deklaroj mbështetjen time për këtë projekt, të cilin e konsideroj jashtëzakonisht të rëndësishëm në bashkëpunimin tonë shqiptar dhe institucioneve të Kosovës. Besoj se është një projekt i rëndësishëm me interes kombëtar, por vetëm nëse do të bazohet në të vërteta, në profesionalizëm dhe në transparencë, duke lënë mënjanë folklorizimin, që shpesh e zhvillojmë edhe ne këtu në Kuvendin e Shqipërisë. Pra, duke u bazuar në fakte shkencore, në të vërteta historike dhe kombëtare, si dhe me objektivitet për të gjitha personalitetet, për ngjarjet dhe për zhvillimet politike.

Duke marrë në analizë historinë tonë të lashtë, por edhe të sotme, dua të ngre një shqetësim për të gjithë ata që do të punojnë. Duam të shkruajmë një histori nëpërmjet enciklopedisë që do të zhvillojmë me Kosovën, por ne nuk kemi një histori tonën reale në Shqipëri, kemi një histori tërësisht me influenca politike dhe reminishenca të qarta të diktaturës komuniste. Mendoj se volumi i enciklopedisë nuk duhet të jetë aq i rëndësishëm sa e vërteta e saj. Ne si shqiptarë duhet të shpëtojmë nga fakti që e shikojmë shpesh veten në rolin e viktimës. Nëse këndvështrimi do të jetë i tillë, do të jemi larg të vërtetës historike për t'i shërbyer interesit tonë.

Dua të kujtoj kolegët se sa qesharake ishte dhe si u debatua enciklopedia e Akademisë së Shkencave të Maqedonisë për shkak të mungesës së të vërtetave dhe keqinterpretimeve të fakteve historike. Pikërisht për këtë po bëj një vërejtje, të cilën duhet ta kenë parasysh ata që do të punojnë me këtë çështje, Akademia e Kosovës dhe e Shqipërisë, por edhe të gjithë mendimtarët, sidomos ata që kanë punuar për të vërtetat historike të shqiptarëve në Malin e Zi, në Maqedoni, në Turqi, në Greqi dhe kudo ku kanë jetuar shqiptarë, kudo ku ka qenë historia jonë. Më lejoni ta mbyll fjalën me një çështje që dua ta ndaj me ju. Ndërkohë që ne inkurajojmë dhe mbështesim akademikët për të bërë punën e tyre, duhet të kemi parasysh edhe detyrimet tona.

Nëse duam të shkruhet një histori e shqiptarëve, duhet të shikojmë edhe të vërtetat e historisë së tanishme, ndaj do t'ju lutesha, kolegë deputetë, që marrëdhëniet tona, sidomos në raport me Kosovën, t'i shikojmë edhe në këndvështrimin e problemeve që Kosova ka sot dhe mbështetjes që mund t'i japim ne. Situata në Veriun e Kosovës është shqetësim i madh dhe Shqipëria, si një vend anëtar i NATO-s,

duhet të jetë e angazhuar maksimalisht për të analizuar bashkë me partnerët, që të mos shkaktohet një konflikt, pasojat e të cilit nuk do të jenë të vogla për ne si shqiptarë dhe për rajonin e Ballkanit.

Mendoj se në këtë projekt të rëndësishëm, ku përfshihen akademitë, takimi i të dyja parlamenteve të dielën duhet të jenë hapi i parë i zhvillimit të një marrëdhënieje të qenësishme parlamentare, që nuk diktohet nga agjenda e qeverisë, por nga vetëdija jonë si deputetë, nga dashuria dhe respekti për njëritjetrin dhe për kombin shqiptar.